



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 69, datë 14.04.2025

PËR

**“MIRATIMIN E KËRKESËS SË MAGJISTRATES AULONA HAXHIRAJ PËR
USHTRIM VEPRIMTARIE JASHTË FUNKSIONI”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/Kryetar
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 14.04.2024, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë” shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e kërkesës së magjistrates Aulona Haxhiraj për ushtrim veprimtarie jashtë funksioni të prokurorit”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim, relacioni shoqërues nr. 1155 prot., datë 09.04.2025, të Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, dëgjoi relatorin Zeqir Hoda, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Brenda kompetencave ligjore dhe nënligjore, Këshilli shqyrton, miraton ose refuzon kërkesat e prokurorëve për veprimtari jashtë funksioni.
2. Në datë 01.04.2025, pranë Këshillit është administruar kërkesa me nr. 1098 prot., datë 01.04.2025, e zonjës Aulona Haxhiraj *“Leje për ushtrim veprimtarie akademike nga Magjistrati”*, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.
3. Referuar përmbajtjes së kësaj kërkesë, si dhe dokumentacionit shoqërues, zonja Haxhiraj kërkon nga Këshilli, autorizimin për ushtrimin veprimtari jashtë funksionit si *Lektore e Jashtme në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane, në lëndën “E drejta Penale Mjedisore”*, për semestrin e dytë të vitit akademik 2024-2025.
4. Zonja Haxhiraj përmes komunikimeve elektronike të datës 04.07.2025, me Këshillin bën me dije se, kompensimi financiar për këtë angazhim do të bëhet në bazë të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit nr. 29, të vitit 2018, duke specifikuar se totali i orëve akademike është 120 (njqind e njëzet) orë dhe kompensimi 940 (nëntëqind e dyzet) lekë për orë.
5. Magjistratja sqaron se kontrata me institucionin arsimor publik do të jetë deri në përfundim të vitit akademik 2024-2025, specifikisht deri më 15 Korrik 2025, dhe se përkatësisht veprimtaria e saj akademike do të kryhet ditën e premte të çdo jave, pra 8 (tetë) orë në javë, prej të cilave 4 (katër) janë brenda orarit zyrtar dhe 4 (katër) jashtë. Magjistratja Haxhiraj në kërkesën e saj specifikon se mban gradën shkencore “Doktor në Shkencat Juridike” dhe së është në proces të fitimit të titullit “Profesor i Asociuar”.
6. Kjo kërkesë shoqërohet edhe nga shkresa me nr. 878/1 prot., datë 07.04.2025, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, përmes të cilës Drejtuesi zoti Petrit Çano qartëson:

“Angazhimi i prokurores Aulona Haxhiraj në mësimdhënie nuk përbën pengesë për ecurinë normale të punës në këtë prokurori dhe se ajo që nga emërimi në korrik 2024 i ka përmbushur me rigorozitet detyrat. Gjithashtu informon se gjatë kësaj periudhe zonja Haxhiraj nuk ka marrë ulje ngarkese në punë.”



7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit konstaton se, prokurorja Aulona Haxhiraj nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.

8. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit, në kohën e kërkuar nga magjistratja brenda orarit zyrtar, rezulton të jetë më i lartë se parashikimet e Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, dhe ndikon negativisht në kohën që magjistratja duhet të ushtrojë përgjegjësitë konform funksionit të prokurorit.

9. Veprimtaria jashtë funksionit në rastin konkret:

- është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
- nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohe sipas ligjit.
- nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;

Gjithsesi, Komisioni arsyeton se kjo kërkesë, e paraqitur nga magjistratja Aulona Haxhiraj, për ushtrim të veprimtarisë jashtë funksionit të prokurorit:

- tejkalon kohën prej 2 orësh në javë, brenda orarit zyrtar, të cituar në nenin 6, “Kushtet për të autorizuar veprimtarinë akademike” të rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”;
- bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke cënuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve të prokurorit;
- institucioni arsimor publik nuk ndodhet brenda të njëjtës njësi administrative dhe magjistrates i duhet të udhëtojë nga njësia ku ushtron funksionin, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, drejt qytetit të Vlorës, çdo ditë të premtë deri më 15 korrik 2025.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se:

10. Në komunikimin elektronik të datës 10.04.2025, ora 12:00, si dhe 14.04.2025, ora 09:45 prokurorja Aulona Haxhiraj ka saktësuar:

“Ushtrimi i veprimtarisë do të kryhet 8 ore në javë, nga të cilat 2 ore do të jenë brenda orarit zyrtar dhe 6 ore jashtë orarit zyrtar. Për me tepër, familja ime (fëmijët dhe bashkëshorti) dhe unë jetojmë në Vlorë. Për shkak të familjes unë në Vlorë shkoj pothuajse përditë dhe nuk më ka ndikuar aspak rruga dhe largësia, e cila është vetëm 1.30 minuta, në ushtrimin e detyrës.

Aktiviteti si pedagoge do të ushtrohet ditën e premtë, në Master Shkencor, i cili sipas orarit zhvillohet gjithmonë në mbasdite, pas orës 14.00.”

11. Kërkesa e prokurores për të ushtruar veprimtari jashtë funksioni sipas objektit të saj dhe qartësimeve të bëra nga Magjistratja nuk tejkalon afatet kohore të specifikuara nga Rregullorja



*“Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve” dhe plotëson kushtet për miratimin e këtij autorizimi për ushtrim veprimtarie jashtë funksioni.*¹

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës, nenin 9 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar, nenin 9, pika 2 të Rregullores *“Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”*, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për veprimtari jashtë funksionit së magjistrates Aulona Haxhiraj.
2. Ky vendim i njoftohet prokurores Aulona Haxhiraj dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 4.04.2025.



KRYETAR

Mirela Bogdani

¹ Zoti Vatë Staka propozoi miratimin e kërkesës së magjistrates Haxhiraj.

Fillimisht u votua Relacioni i Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit: Votuan “Pro”: zoti Zeqir Hoda, zonja Ledina Riza dhe zoti Erion Fejzulla. Votuan “Kundër”: zonja Mirela Bogdani, zoti Sokol Stojani, zoti Moisi Duda, zoti Vatë Staka, zoti Olger Eminaj, zoti Erind Germenji dhe zoti Erind Merkuri. Në mungesë zonja Arta Mandro.

Më pas u votua propozimi i zotit Staka. Votuan “Pro”: zoti Vatë Staka, zoti Erind Germenji, zoti Erind Merkuri, zoti Sokol Stojani, zonja Mirela Bogdani, zoti Olger Eminaj, zoti Moisi Duda. Votuan “Kundër”: zonja Ledina Riza, zoti Erion Fejzulla dhe zoti Zeqir Hoda. Në mungesë zonja Arta Mandro.